

Pse vetëvendosje?

Vetëvendosja është e drejtë e të gjithë popujve të kolonizuar.

Mungesa e përgatitjes në fushat politike, ekonomike, shoqërore, apo në atë të arsimit kurrë nuk duhet të merret si pretekst për të vonuar pavarësinë. (Rezoluta 1514 e OKB-së, më 1960)

VETËVENDOSJE!
<http://www.vetevendosje.org>

Fletushkë e Lëvizjes VETËVENDOSJE!

KËTË JAVË:

- Tubim në Plepas, Besianë
- Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN) ndërhyr në fondin e privatizimit
- Spastrimi i UÇK-së me FSK
- Demonstrata e Lagjes së Boshnjakëve

Mbledhja në Plepas, Besianë

Të martën më 20 janar, Lëvizja VETËVENDOSJE! mbajti tubim publik në fshatin Plepas të Besianës. Albin Kurti shpjegoi se ekzistojnë katër sfida të mëdha me të cilat ballafaqohet populli i Kosovës në vitin 2009: bisedimet me Sërbinë rreth 6 Pikave; decentralizimi si pjesë e Planit Ahtisar-i dhe kushti për zgjedhjet lokale; privatizimi i kompanive kyçe publike në Kosovë (Trepçës, PTK-së, KEK-ut dhe Aeroportit); dhe në fund, ndikimi i krizës financiare në botë në krizën ekonomike të vendit tonë. Aktivistët Xhelal Sveçla dhe Hysen Durmishi argumentuan se është çasti i fundit që populli të organizohet dhe të protestojë nëpër vendbanimet e veta dhe në Prishtinë për t'i ndaluar këto procese.

Këto janë disa nga pyetjet që u parashtruan nga pjesëmarrësit në tubim:

- Ibrahim Shabani kërkoi të dinte më tepër për bisedimet e Prishtinës me Beogradin. Albini u përgjegg se motoja, JO NEGOCIATA – VETËVENDOSJE! vlen ende, megjë bisedimet me Beogradin kanë për qëllim zbatimin e 6 Pikave.
- Ahmet Ademi pyeti nëse kishte ndodhur diçka e mirë pas shpalljes së pavarësisë. Albini u përgjegg se gjëja e vetme e mirë ishte njohja ndërkombëtare nga vendet më të fuqishme të botës, por Kosova ka më shumë nevojë për sovranitet mbi tërë territorin e saj se sa për njohje.
- Blerim Dibrani pyeti për vendosjen e EULEX-it. Albini u përgjegg se neve na duhet që institucionet e Kosovës ta zbatojnë autoritetin e tyre në gjithë Kosovën. Në Kosovë duhet të ketë prani ndërkombëtare si këshilldhënës dhe ndihmues, por jo si pushtet ekzekutiv me imunitet para ligjit.
- Ruzhdi Rexhepi e pyeti Albinin nëse bashkimi kombëtar është i mundshëm. Albini tha se është më mirë të nisemi nga ajo çka është vullneti ynë se sa nga ajo çka është e mundur, sepse kur

fillohet me vullnet, çdo gjë është e mundur. Ai shpjegoi se është më mirë të niset me hapa të vegjël, p.sh. me libra të njëjtë shkollor në shkollat shqipe, t'u ofrohet gjithë shqiptarëve kudo që janë shtetësi e dyfishtë dhe projekte të tjera si shkëmbimi i studentëve dhe ekskursi-onet turistike.

PCN-ja vendos për fondet e AKM-së
Pieter Feith këtë javë ndërhyri në lidhje me vendimin e AKP-së për investimin e fondeve tona të privatizimit brenda Kosovës. Duke argumentuar se investimi i këtyre fondeve jashtë Kosovës do të ishte më i sigurt, Feith u përzie drejt-përdrejt në të drejtën e institucioneve të Kosovës për të marrë vendime rreth ekonomisë së Kosovës. Feith dëshiron që ne të besojmë se PCN nuk ka lidhje me të kaluarën (periudhën e UNMIK-ut), për ç'arsye ai ka kujdes që pushtetin ekzekutiv të mos e zbatojë shumë publikisht. 'Këshilla' e tij e thënë publikisht mbi fondet e privatizimit, në të vërtetë duhet të kuptohet jo thjesht si dëshira e tij, por si urdhri i tij. Kjo është arsyeja pse nuk ka pasur kurrfarë veprimesh AKP për kthimin e fondit të privatizimit dhe as që do të ketë

Prapa kësaj ndërhyrjeje qëndron mungesa e vullnetit për t'ia dhënë Kosovës kontrollin mbi këto fonde, ngase Serbia ende deklaroi se kompanitë e privatizuara janë pronë e saj. Kosova domosdoshmërisht ka nevojë për investime në fushat e duhura për krijimin e vendeve të reja të punës dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik. Kjo do të mund të na jepte pak shpresë. Privatizimi i industrisë shoqërore ka për qëllim krijimin e fondeve të cilat mund të investohen për të mirë të qytetarëve. Pieter Feith na e mohoi të drejtën e zgjedhjes nëse duam ta bëjmë një gjë të tillë ose jo.

Spastrimi i UÇK-së me FSK

Pas krijimit të Forcave të Sigurisë së Kosovës, këtë javë, tre komandantë të lartë të TMK-së dhanë dorëheqje në shenjë proteste ndaj mungesës së transparencës në procesin e përzgjedhjes dhe ndërhyrjes nga jashtë. Ish ushtarët e TMK-së kanë protestuar dhe Lëvizja VETËVENDOSJE! i ka përkrahur protestat e tyre dhe vazhdon të kërkojë

Nr.131, 26 janar 2009

që Kosova ta ketë të drejtën për ushtri të njëmendtë si shtetet e tjera.

Është bërë e qartë se, ashtu si e patëm parashikuar, kanë qenë kriteret politike ato të cilat i kanë paraprirë rekrutimit të oficerëve të FSK-së, njëjtë sikur me rastin e rekrutimit të oficerëve të Shërbimit Policor të Kosovës. Dalëngadalë pjesëtarët e ndershëm të UÇK-së, të cilët ishin punësuar në SHPK, u larguan. Po në këtë mënyrë, ushtarët më profesionalë dhe më patriotë u lanë jashtë FSK-së.

Kjo është në interes të qeverisë, ngase partitë politike në Kosovë janë klan i interesave të ngushta, të cilët mbështeten në banda për zbatim të qëllimeve të tyre. Kjo i shkon për shtati bashkësisë ndërkombëtare, e cila nuk dëshiron që Kosova të ketë ushtri, ngase ushtria është elementi më i rëndësishëm i sovranitetit. NATO ka qenë shumë e qartë: FSK-ja nuk është ushtri dhe nuk ka kompetenca ushtarake. Pa ushtri, ekzistenca e Kosovës gjithmonë do të varet nga mbrojtja e NATO-s dhe, në këtë mënyrë, Kosova gjithmonë do të varet politikisht nga prania ndërkombëtare.

Demonstrata e Lagjes së Boshnjakëve

Këtë javë Lëvizja VETËVENDOSJE! e mbështeti protestën 24 orëshe të banorëve shqiptarë të Lagjes së Boshnjakëve të Mitrovicës së veriut, të cilët janë të dëshpëruar pse kurrfarë forcash të sigurisë nga institucionet e Kosovës nuk janë vendosur atje për t'i mbrojtur ata dhe familjet e tyre, sidomos gjatë dhunës së strukturave paralele të Serbisë në mujin dhjetor dhe janar. Këta banorë detyrohen t'i ruajnë shtëpitë e tyre gjatë natës sepse nuk kanë mbrojtje policore. Policët e SHPK-së të pranishëm atje janë të gjithë nën kontrollin e strukturave paralele serbe. Dyqanet e shqiptarëve u dogjën pas të ashtuquajturës vendosje të EULEX-it në veri. Ne e përkrahim kërkesën shumë të thjeshtë të banorëve për mbrojtje nga policia, e cila duhet t'i mbrojë interesat e popullit të Kosovës.